

## KËSHILLIMI DHE ORIENTIMI PËR KARRIERË

Tipi i Programit: Themelor

Historiku i Programit

Orientimi për karrierë është identifikuar si pikë kyçe në Planin Strategjik për Zhvillimin e Arsimit në Kosovë (PSAK) 2017-2021 (Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, 2016). Mungesa e orientimit për karrierë në kombinim me mungesën e informatave të tregut janë shkaktar të mos përshtatjes së kërkesave të tregut dhe shkathtësive të nxënësve dhe rjedhimisht edhe në mundësitë dhe ofertat e shkollimit dhe punësimit. Orientimi për karrierë është i rëndësishëm edhe për nxënësit, prindërit e tyre dhe mësimdhënësit në shkolla. Trajnimi i mësimdhënësve të cilët në kombinim me ekspertizën profesionale lëndore kryejnë edhe detyra tjera në shkollë si kujdestari, udhëheqje të klubeve dhe aktiviteteve tjera jashtë kurrikulare ju jep mundësi atyre të identifikojnë prirjet e nxënësit, këshillojnë dhe inspirojnë ata në mënyrë profesionale. Tema e këshillimit dhe orientimit në karrierë është aktuale edhe më tutje për Ministrinë e arsimit, Drejtoritë komunale dhe shkollat. Prandaj ky program trajnimi do të kërkohet edhe një kohë të gjatë.

Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar të Kosovës (Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, 2016) në Shk 5 dhe Shk 6 - për gjimnaze përfshinë konceptet e TIK-ut, këshillimin dhe orientimin në karrierë, ndërmarrësinë dhe edukimin për zhvillimin e qëndrueshëm, kurse tek shkollat profesionale përfshihet edhe Teoria dhe praktika në profesion (varësisht nga profili arsimor).

Programi trajnues 'Këshillim dhe Orientim për karrierë', është konceptuar në konsultim të vazhdueshëm me koordinatorët përgjegjës për kurrikulën e fushës 'jeta dhe puna' në MASHt, ku si pikënisje fillestare ka qenë nevoja për zhvillimin profesional të mësimdhënësve të kësaj fushe, si mbështetje e drejtëpërdrejtë e reformës kurrikulare. Kjo fushë mban në vete tri koncepte kryesore, ndërmarrësinë, orientimin dhe këshillimin për karrierë, dhe, Teknologjinë e informacionit dhe të komunikimit. Në bashkëpunim me zyrtarët përgjegjës për trajnime në MASHt, është menduar të përgatitet një pako trajnuese për mësimdhënësit e kësaj fushe, e cila përmban të tri konceptet kurrikulare. Fillimisht, secili program trajnues do të hartohet dhe pilotohet veçmas, para se të grupohen në pakon prej tre programeve të kësaj fushe kurrikulare.

Gjatë vitit të parë të ASSET-it, janë hartuar dhe pilotuar dy nga tri programet e përmendura më lart:

1. 'Ndërmarrësia dhe edukimi financiar', dhe
2. 'Orientimi dhe këshillimi për karrierë'.

Qëllimet e programit:

Me përvetësimin e këtij programi pjesëmarrësit duhet të jenë gjendje të:

- Identifikojnë aktivitetet e KOK të dalura nga rezultatet e pritura mësimore të përshkruara në Kurikulin e Kosovës
- Përdorin platformën elektronike [busulla.com](http://busulla.com) për të demonstruar kërkimin për shkolla dhe IAL, për të diskutuar për profesione dhe për të bërë teste të ndryshme të karrierës si testi i karrierës dhe Basic Check, etj.
- Analizojnë dhe zhvillojnë një metodë të mësimdhënies duke përdorur qasjen e bazuar në rezultate
- Reflektojnë mbi mësimdhënien e tyre dhe të japin vlerësime konstruktive kolegjale

#### Përmbajtja:

Ky program trajnues i adreson konceptet e këshillimit dhe orientimit për karrierë, dhe paraqet një të tretën e materialit që pritet të realizohet nga fusha 'jeta dhe puna' (pjesa për 'Ndërmarrësinë' dhe 'Teknologjinë e informacionit', janë programe të veçanta trajnimi). Përmes trajnimit të mësimdhënësve në këtë program do të zërthehen konceptet e karrierës në aktivitete konkrete, duke i lidhur ato me rezultatet mësimore të fushës 'jeta dhe puna'. Në këtë aspekt do të punohet me plane konkrete mësimore të klasëve ku mësimdhënësi mban mësimin. Gjatë implementimit të njohurive me nxënësit në klasë, mësimdhënësit do të mbajnë portfoliot e tyre, të cilat do ti prezantojnë në ditën e fundit të trajnimit. Të gjithë pjesëmarrësit në trajnim do të jenë në gjendje që të shfrytëzojnë platformën elektronike [busulla.com](http://busulla.com), dhe të njëjtat do ti përcjellë te nxënësit e tyre por edhe te prindrit e nxënësve. Tërë procesi i trajnimit do të jetë i mentoruar nga fasilituesit profesional.

#### Grupi i synuar

Të gjithë mësimdhënësit e fushës 'jeta dhe puna' të shkollave të mesme të larta, Gjimnazeve dhe shkollave profesionale, respektivisht klasave X, XI, dhe XII. Numri i tyre mund të arrijë 600, për të cilët ky program trajnimi do të duhej të ishte themelor sa i përket licencimit të tyre. Në kuadër të programit ASSET të KEC-it, janë certifikuar 103 mësimdhënës të gjimnazeve partnere. Por, ky program trajnimi është i përshtatshëm edhe për mësimdhënësit e fushave tjera mësimore të këtij niveli të shkollimit, si trajnim plotësues, numri i të cilëve nuk është i kufizuar. Në ndërkohë, është përgatitur edhe doracak për mësimdhënës të gjimnazeve, i cili është i bazuar në këtë kurs dhe në kurrikulin e fushës 'jeta dhe puna'.

#### Forma e organizimit / Kohëzgjatja

Pjesëmarrësit e identifikuar paraprakisht do të marrin detyrat përgatitore duke pranuar materialin për lexim fillestar. Pastaj, pjesëmarrësit do të vijojnë tri ditë të plota, secila ditë me nga katër sesione 90 minutëshe, të moderuara nga fasilituesit profesional. Ndërmjet ditëve të trajnimit do të ketë hapësirë kohore prej disa javësh, për të zbatuar aktivitetet me nxënësit e tyre, dhe gjatë kësaj periudhe do të mentorohen nga fasilituesit e programit, që të mbeshteten në përmbushjen e kërkesave për certifikim.

Gjithsejt programi organizohet me gjithsejt 24 orë angazhim kohor:

6 orë x 3 ditë= 18 orë kontaktuese

6 orë për implementimin e aktiviteteve dhe pjesëmarrjes në takimet reflektuese (përgatitje, konsultime online, observime në klasë, etj.)

#### Vlerësimi/Certifikimi

Në fund të këtij trajnimi pjesëmarrësit mësimdhënë do të certifikohen duke u kredituar me gjithsejt 24 orë trajnimi.

Kriteret për certifikim janë:

- 90% pjesëmarrje në trajnim dhe në takimet reflektuese me mentor;
- Portfolio që dëshmon se janë zbatuar aktivitetet në klasë sipas kërkesave në udhëzim të programit trajnues (me së paku 5 plane mësimore të lidhura me rezultatet mësimore / apo një projekt mësimor); [për mësimdhënësit e fushave tjera mësimore (përveç 'jeta dhe puna') janë të mjaftueshme 2 plane mësimore]

#### Materialet e trajnimit

- Udhëzuesi për fasilitues; prezantimet me sllajdet e kursit për Këshillim dhe në Karrierë; Pyetësor për Mësimdhënësit;
- Web faqja: <https://busulla.com>;
- Manualet e Busullës;
- Videot e profesioneve;
- Doracaku për mësimdhënësit